

20240761583

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BUXHETE

Neni 1

Në Ligjin e Buxheteve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 203/22), në nenin 11, paragrafi (19), ndryshon si vijon:

„Shërbimi profesional i Këshillit Fiskal përbëhet nga katër analistë profesionalë dhe dy të punësuar për mbështetje administrativo-teknike të punës së Këshillit Fiskal. Organizimi i brendshëm dhe përshkrimet e vendeve të punës përcaktohen me rregullore, të cilën e miraton Këshilli Fiskal.“.

Neni 2

Pas nenit 11, shtohet neni i ri 11-a, si vijon:

"Neni 11-a

(1) Rrogat e të punësuarve të Shërbimit profesional të Këshillit Fiskal, përkatësisht drejtuesit dhe analistëve, rregullohen në bazë të koeficientëve në vijim për:

1) Udhëheqës i Shërbimit profesional të Këshillit Fiskal, koeficienti 3,40.

2) Analistët e Shërbimit profesional të Këshillit Fiskal, koeficienti 3,10.

(2) Vlerën e bazës e përcakton Këshilli Fiskal në kuadër të buxhetit të përcaktuar të Shërbimit Profesional të Këshillit Fiskal.

(3) Pagesa e rrogës për nëpunësit administrativ, të cilët nuk kryejnë punë profesionale lidhur me punën e Këshillit fiskal, bëhet në pajtim me Ligjin e Nëpunësve Administrativë.“.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.